



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan,
Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net
tel: 0280390112

Ref. nr. 02/1245 dt. 09 / 06 /2021

Në mbështetje të Nenit 23 parag.1, nën paragrafët: 1.3, 1.6 dhe 1.6.2 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, Këshilli Drejtues në mbledhjen XXXI, të mbajtur më 25.05.2021, miraton këtë:

Rregullore për të ardhura personale dhe pagesa të tjera të personelit akademik në Universitetin "Kadri Zeka" Gjiilan

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Mjetet për të ardhurat personale shfrytëzohen nga fondi i Buxheti të Kosovës, nga tarifat e shkollimit dhe pagesat tjera, të cilat i bëjnë studentët nga pagesat për shërbime komerciale, shërbime të tjera, si: donacionet, dhuratat, ndihma të tjera, si dhe nga kontratat me organizma kombëtarë, ndërkombëtarë, publik dhe privat.
2. Nga këto burime financiare paguhen të ardhurat personale dhe kompensimet tjera për personelin akademik dhe jo akademik në marrëdhënie të rregullt pune, si dhe puna mbi normë dhe puna me honorar për personelin akademik të Universitetit "Kadri Zeka" (në tekstin e mëtejme: Universitetit).
3. Lartësia e të ardhurave personale caktohen në bazë koeficienteve dhe thirrjeve të koduara në shërbimin qendror për të ardhurat sipas kodimit unik për tërë arsimin në Kosovë.

II. DISPOZITAT E VEQANTA

Neni 2

1. Shërbimi për financa i Universitetit e bënë përlllogaritjen e të ardhurave personale dhe pagesave tjera në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit për angazhimin e personelit akademik për çdo vit akademik, përkatësisht raporteve të dorëzuara deri më datën 5 të muajit vijues.
2. Mbi këtë bazë menaxheri, përkatësisht personi i autorizuar jep urdhër për realizimin e pagesave sipas kontratave, të cilat lidhen me të punësuarit me rastin e angazhimit.

Neni 3

1. Me personelin akademik të Universiteti në marrëdhënie të rregullt pune, në pajtim me dispozitat ligjore lidhet kontratë pune:
 - 1.1. me normë të plotë
 - 1.2. me gjysmë normë dhe
 - 1.3. me honorar (mbi normë), përkatësisht edhe kontratë për shërbime të veçanta.
2. Universiteti mund të lidhë kontratë punë me honorar me personelin akademik me kohëzgjatje më së shumti për një vit akademik.
3. Në rastet kur personelit akademik i ka skaduar kontrata e punës, si pasojë e shtyrjes apo vonesave që mund të dalin në përfundimin e procedurave të rizgjedhjes/avancimit, të njëjtëve, me kërkesë të Këshillit të Fakultetit, Senati vendos për vazhdimin e kontratave të punës në thirrjen aktuale për një vit akademik, përkatësisht deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Senatit lidhur me konkursin përkatës.
4. Personeli akademik nuk mund të themelojë dy marrëdhënie të rregullta pune me orar të plotë.
5. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ mund të angazhohet me honorar në institucione tjera, pasi që më parë të ketë marrë pëlqimin nga Dekani dhe miratimin nga Rektori i UKZ-së.

III. PERSONELI AKADEMIK

Neni 4

RREGULLORE PËR TË ARDHURA PERSONALE DHE PAGESA TJERA TË PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "KADRI ZEKA" GJILAN

1. Për personelin akademik të punësuar në Universitetet përcaktohet norma javore e orëve dhe lartësia e pagës sipas titujve akademikë si në vijim:

1.1. Personeli akademik me normë të plotë të punës

Titulli	Ore/javë	Vlera monetare (€) Euro
<i>Profesorët e rregullt</i>	<i>6 orë/javë</i>	<i>1486.72</i>
<i>Profesorët e asocuar</i>	<i>6 orë/javë</i>	<i>1334.67</i>
<i>Profesorët asistent</i>	<i>6 orë/javë</i>	<i>1182.62</i>
<i>Ligjëruesit</i>	<i>6 orë/javë</i>	<i>1030.57</i>
<i>Lektorët</i>	<i>10 orë/javë</i>	<i>878.52</i>
<i>Koorepetitorët</i>	<i>10 orë/javë</i>	<i>878.52</i>
<i>Asistentët</i>	<i>10 orë/javë</i>	<i>803.40</i>

1.2. Asistentit, lektorit dhe ligjëruesit me gradë shkencore Dr.sc. i shtohet edhe një pagesë në lartësi prej 100 €, mbi pagën bazë të përcaktuar si në nënparag.1.1. të këtij Neni.

1.3. Kompensimi funksional sipas posteve udhëheqëse

<i>Posti – funksioni</i>	<i>Paga €</i>		
<i>Rektori</i>	<i>1486.72</i>	<i>650</i>	<i>2136.72</i>
<i>Prorektori</i>	<i>1486.72</i>	<i>450.00</i>	<i>1936.72</i>
<i>Dekani</i>	<i>1486.72</i>	<i>350.00</i>	<i>1836.72</i>
<i>Prodekani</i>	<i>(paga)</i>	<i>250.00</i>	<i>Paga + 250</i>
<i>Sekretari i përgjithshëm</i>	<i>(paga)</i>	<i>250.00</i>	<i>Paga + 250</i>
<i>Koordinatori i Fakultetit për cilësi dhe akreditim</i>	<i>(Paga)</i>	<i>100.00</i>	<i>Paga + 100.00</i>
<i>Shefi i departamenti/koordinator apo shefi i programeve studimore</i>	<i>-----</i>	<i>100.00</i>	<i>Paga + 100.00</i>
<i>Koordinatori i qendror për praktikë të studentëve dhe bashkëpunim</i>	<i>(Paga)</i>	<i>100.00</i>	<i>Paga + 100.00</i>
<i>Këshilltar i Rektorit</i>	<i>(Paga)</i>	<i>300.00</i>	<i>Paga + 300.00</i>
<i>Drejtor i Institutit</i>	<i>(Paga)</i>	<i>120.00</i>	<i>Paga + 120.00</i>

1.4. Norma dhe mbi norma e stafit menaxhues

Posti-funksioni	Norma	Mbi norma
<i>Rektori</i>	<i>0 orë</i>	<i>6 orë</i>
<i>Prorektori</i>	<i>0 orë</i>	<i>6 orë</i>
<i>Dekani</i>	<i>0 orë</i>	<i>6 orë</i>
<i>Prodekani</i>	<i>3 orë</i>	<i>6 orë</i>
<i>Anëtari i KO</i>	<i>3 orë</i>	<i>6 orë</i>

1.5. Anëtarëve të Këshillit Drejtues ju takon paga + shtesa sipas vendimit të MASHT-it, Nr. 260101 B, dt. 29/06/2015:

1.5.1. Komisionet funksionale të Këshillit Drejtues do të paguhen: Kryetari 100 €, anëtari 60 €.

1.5.2. Komisionet funksionale nuk mund të takohen më shumë se 4 herë për një çështje të caktuar.

2. Mbi normë dhe honorar

2.1. Personeli akademik i Universitetit në marrëdhënie të rregullt (Profesor i rregullt, Profesor i asocuar, Profesor Asistent) që janë në marrëdhënie të rregullt pune në Universitet mund të mbajnë deri në 6 orë në javë.

2.2. Për personelin akademik nga parag. 2.1. në mungesë të normës së plotë në studimet bachelor, norma mësimore duhet të plotësohet edhe me orët nga studimet master dhe atë 1 orë ligjërata në studime master, që do të jetë e barabartë me 1 orë ligjërata në studimet bachelor, plotësimi i normës bëhet edhe me orë, të cilat do t'i mbajë në njësitë tjera akademike brenda UKZ-së.

2.3. Lektori, asistenti, që janë në marrëdhënie të rregullt pune në universitet mund të mbajnë deri në 6 orë në javë mbinormë.

2.4. Për personelin akademik, njësia akademike është e obliguar që t'i sigurojë orë mësimore deri në normën e plotë. Në rastin kur mësimdhënësit i ofrohen orë për plotësimin e normës dhe ai nuk e pranon, pagesa i behet proporcionalisht me numrin e orëve, të cilat i mban.

2.5. Orët mbi normë nuk mund t'i jepen personelit akademik, i cili e ka normën e plotë, përderisa nuk i plotësohet norma e mësimdhënësve, përkatësisht asistentëve në marrëdhënie të rregullt pune nga lëmi i njëjtë.

2.6. Në rast kur mësimdhënësit në marrëdhënie të rregullt pune nuk i plotësohet norma për secilin semestër, ai normën e plotëson me orët e mbajtura mbinormë nga semestri tjetër. Nëse mësimdhënësit nuk mund t'i plotësohet norma e plotë e orëve të ligjëratave edhe në semestrin e dytë, atëherë normën mund ta plotësojë me orë të ushtrimeve në raport 1 me 1, por jo më shumë se 2 orë ushtrime nga tërësia e normës.

2.7. Përjashtimisht nga paragrafi 2.6, kur mësimdhënësi ka orë më shumë të ushtrimeve sesa që i nevojiten për plotësimin e normës, me një arsyetim të veçantë me shkrim nga Dekani i fakultetit, Rektori mund të merr vendim për pagesën e orëve të ushtrimeve në proporcion 2:1.

2.8. Asistentëve nuk mund t'iu kompensohen orët e ligjëratave. Në raste të veçanta, me kërkesë të Këshillit të Fakultetit dhe Dekanit të njësisë akademike, kur konstatohet se nuk ka mundësi të angazhimit të personelit adekuat, asistenti me Mr dhe MSc që ka të regjistruar doktoratën mund të angazhohet për mbajtjen e ligjëratave, në këtë rast pagesa do të bëhet në bazë të thirrjes akademike-asistent.

2.9. Personeli akademik që nuk ka marrëdhënie të rregullt pune në Universitet, por që angazhohet jashtë Universitetit, mund të mbajë deri në 6 orë ligjërata në javë, ndërsa asistenti deri në 10 orë ushtrime në javë.

2.10. Angazhimi i personelit akademik me orë mbi-normë dhe me honorar në Universitet bëhet në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit në propozim të njësisë akademike, më së voni deri më 30 shtator të vitit vijues.

3. Lartësia e kompensimi për orët e mbajtura mbi-normë

Emërtimi i thirrjes	Vlera bruto €
<i>Profesorët e Universitetit dhe ata me thirrje akademike nga universitetet publike</i>	30
<i>Për ligjëruesit e jashtëm me gradë Dr.sc.</i>	20
<i>Për ligjërues, lektorë</i>	17
<i>Për asistentë</i>	16
<i>Profesorët vizitorë nga universitetet e vendeve, me të cilat kufizohet Republika e Kosovës, duke përfshirë Bosnjën e Hercegovinën</i>	40
<i>Profesorët vizitorë nga universitetet e vendeve tjera jo fqinje të Republikës së Kosovës</i>	50

3.1. Profesorët vizitorë jashtë territorit të Kosovës, mund të angazhohen vetëm me propozimin e arsyetuar të Dekanit e të miratuar në Këshillin e Fakultetit, i cili aprovohet nga Rektori.

3.2. Profesorët vizitorë nga universitetet e vendeve jo fqinje të Kosovës mund të kompensohen për shpenzimet e biletës së udhëtimit, por jo më shumë se dy bileta vajtje-ardhje në vit. Për këtë vendos me vendim të veçantë Këshilli Drejtues.

3.3. Kompensimi për mësimin mbi-normë dhe stafin e angazhuar bëhet për 9 muaj brenda viti akademik, përkatësisht 15 javë për ligjërata/ushtrime në një semestër dhe dy javë për semestër që kompensojnë dy afate të provimeve.

3.4. Kompensimi bëhet për orët e mbajtura. Kjo vlen edhe për javën e pestë të muajit me pesë javë, e cila kompensohet në muajin e fundit të semestrit.

3.5. Kontrata sipas semestrave lidhet në kohëzgjatje:

3.5.1. për semestrin dimëror 1 tetor - 15 shkurt të vitit pasues;

3.5.2. për semestrin veror 16 shkurt - 30 qershor.

3.6. Rektori i Universitetit me propozimin e Dekanit të njësisë akademike, në raste të veçanta me një arsyetim të bazuar, ka mundësi që me vendim të veçantë ta rrisë angazhimin e personelit akademik (profesorëve) nga jashtë ose brenda Universitetit, por jo më shumë se 2 orë më shumë se mbi norma e lejuar.

IV. SANKSIONET

Neni 5

1. Personeli akademik, i cili pa arsye/leje paraprake mungon nga procesi mësimor, mbajtjen e provimeve dhe kujdestarisë, do të sanksionohet me heqje proporcionale të pagës (për profesorë, -1 orë mësimi =60 €, për asistentë, -1 orë=30 €).

2. Dekani i njësisë akademike obligohet që të zbatojë sanksionet e përcaktuara sipas rregullores, në rast se Dekani nuk raporton për orët e humbura ose për mos mbajtjen e provimeve do të sanksionohet me 50% të shtesës funksionale.

3. Në rastet kur anëtari i komisionit recensues nënshkruan recension në kundërshtim me dispozitat e Statutit të UKZ-së; rregulloret e brendshme të Universitetit apo legjislacionin në fuqi e të konstatuara nga Senati, rasti dërgohet për trajtim në Këshillin e Etikës dhe nuk kompensohen për punën e kryer.

V. KRITERET THEMELORE PËR FORMIMIN E GRUPEVE PËR PUNË MËSIMORE

Neni 6

1. Përcaktimi i grupeve në bazë të numrit të studentëve për ligjërata:

Ligjërata		Ushtrime	
Obligative	deri 60	Obligative	deri 30
Zgjedhore	deri 40	Zgjedhore	deri 30

2. Për lëndë specifike, me çrast kërkohen kushte të veçanta, profesori i lëndës me një arsytim mund të kërkojë nga Këshilli i Fakultetit, që grupet e ligjëratave/ushtrimeve të formohen në numër më të vogël.

3. Për vitin e parë, minimumi i numrit të studentëve për mbajtjen e ligjëratave/ushtrimeve duhet të jetë 5 (pesë). Për vitet e tjera, numri i studentëve për mbajtjen e ligjëratave/ushtrimeve duhet të jetë minimum 3 (tre).

VI. LARTËSIA E KOMPENZIMIT PËR PUNIME TË DIPLOMËS

Neni 7

1. PAGESA PËR MBROJTJE TË DIPLOMËS NË STUDIMET BACHELOR BËHET SI NË VIJIM:

1.1. Mentorit.....30 € euro

1.2. Anëtarët e komisionit.....10 € euro

2. Për një afat të diplomimit mentori mund të paguhet më së shumti për 5 (pesë) kandidatë.

3. Për një vit akademik mentori mund të paguhet më së shumti për 15 (pesëmbëdhjetë) kandidatë.

VII. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR UDHËHEQJE TË KANDIDATIT NË STUDIMET MASTER

Neni 8

1. Kompensimi për udhëheqje të kandidatit për studime master bëhet si në vijim:

1.1. Mentori.....250 Euro

2. Për një vit akademik mentori mund të paguhet më së shumti për 5 (pesë) kandidatë brenda UKZ-së.

**VIII. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR KOMISIONIN PËR VLERËSIM DHE
MBROJTJE TË PUNIMIT TË DIPLOMËS PËR STUDIME MASTER**

Neni 9

1. Kompensimi i komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të diplomës për studentët master bëhet si në vijim :

1.1. Kryetari i komisionit.....100 euro

1.2. Anëtarët e komisionit (2) x 80 euro

**IX. MËNYRA E REALIZIMIT, VERIFIKIMIT DHE MONITORIMIT TË PAGESAVE PËR
ORËT MBI NORMË DHE PROVIZIONET E TJERA**

Neni 10

1. Çdo orë e paraqitur për pagesë duhet të arsyetohet me listat e studentëve të pranishëm, të verifikuara nga personi i autorizuar i fakultetit;

2. Raportet duhet të paraqiten deri me datë 5 të muajit të ardhshëm;

3. Raportet për orët e mbajtura, të dorëzuara nga mësuesi më vonë se 1 muaj, nuk do të paguhen.

X. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR STUDIME TË DOKTORA TURËS

Neni 11

1. Një mësues nuk mund të udhëheqë më tepër se dy kandidatë për doktoratë brenda një viti akademik.

2. Kompensimi për studimet e doktoratës bëhet si në vijim:

2.1. Kompensimi për orët e mbajtura për grupin e kurseve të përgjithshme 1 orë ligjërata = 40 €, por jo më shumë se 28 orë për semestër

2.2. Kompensimi për orët e mbajtura për grupin e kurseve profesionale 1 orë ligjërata = 40 €, por jo më shumë se 12 orë për semestër

2.3. Komisioni për vlerësim të punimit:

2.3.1. Mentori.....1200 €

2.3.2. Kryetari i komisionit.....200 €

2.3.3. Anëtar i komisionit.....150 €

2.4. Komisioni për mbrojtje publike:

2.4.1. Anëtari i komisionit (3) anëtar nga 200 €

3. Për kandidatët, të cilët mbrojnë punimin e doktoratës në Universitetin "Kadri Zeka" dhe kanë anëtar të komisionit jashtë Kosovës, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i heq Universiteti.

XI. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR REKRUTIMIN E STAFIT AKADEMIK

Neni 12

1. Kompensimi për komisionin recensues do të bëhet si në vijim:

1.1. Kryetari i komisionit.....100 €

1.2. Anëtarët e komisionit recensues.....2 x 60 €

2. Kompensimi për komisionin e ankesave të shkallës së parë, në lidhje me parag.1 të këtij neni.

2.1. Kryetari i komisionit.....50 €

2.2. Anëtarët e komisionit.....2 x 30 €

XII. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 13

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit "Kadri Zeka" shfuqizohet rregullorja me Nr. Ref. 02/1486, dt. 10.12.2015.

Neni 14

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Këshillit Drejtues.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues


MSc. Ibrahim Kosumi